

UDHËZUES NDERKOMBETAR PËR ORGANIZATËN E SOS FSHATRAVE TË FEMIJEVE

Udhëzime per Anti-Korrupsionin dhe Anti-Mashtrimin

Janar 2010

Ky udhëzues është në përdorim për:

- 1 Të gjithë shoqatat anëtare të SOS-Kinderdorf International
- 2 Të gjithë zyrat e Sekretariatit të Përgjithshëm të SOS-Kinderdorf International
- 3 Të gjithë anëtarët e bordit dhe gjithë punonjësit e SOS-it.
- 4 Të gjithë njerezit të cilët punojnë për SOS Fshatrat e Fëmijeve apo në interes të saj.

Përmbajtja

<u>1. Hyrje</u>	3
<u>2. Qëllimi dhe Shtrirja</u>	4
<u>3. Parimet bazë</u>	4
<u>4. Përkufizime dhe Shkurtime</u>	5
<u>5. Pasojat e Korrupsionit</u>	7
<u>6. Përgjegjësitë</u>	7
<u>7. Raportimi dhe Procedura e Investigimit</u>	10
<u>8. Sanksionimet dhe Masat ligjore</u>	11
<u>9. Cështje të vecanta</u>	11

1. HYRJE

“Ne kemi marrë përsipër të përdorim të gjithë fondet dhe burimet me mençuri, me respekt dhe përgjegjësi”

(Kush jemi ne – vlerat - përgjegjësia)

Të gjitha format e Mashtrimit dhe Korrupsionit janë të papranueshme për SOS Fshatrat e Fëmijëve, që luan një rol aktiv në luftën kundër saj.

SOS Fshatrat e Fëmijëve (SOS) ndërton familje për fëmijët në nevojë, i ndihmon ata të krijojnë të ardhmen e tyre, dhe kontribuon në zhvillimin e komuniteteve të tyre. Për të arritur këtë, ne kemi marrë përsipër të sigurojmë që të gjitha burimet të cilat na janë besuar, të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat jepen.

Cdo punonjës luan një rol të rëndësishëm këtu dhe ka për detyrë të sigurojë që burimet përdoren dhe justifikohen sic duhet.

SOS-i mund të vazhdojë punën e tij vetëm nëse arrin të ruajë nivelin e lartë të besimit me partnerët e vet. Dhe kjo mund të arrihet duke zhvilluar një drejtim të mirë dhe duke parandaluar korrupsionin dhe mashtrimin në të gjitha nivelet brenda organizatës. Për të qenë të suksesshem, kërkohet që cdo individ të respektojë vlerat etike si:

Kurajo - Përkushtim - Besim - Përgjegjësi

Mënyra se si një organizatë i jep drejtim dhe merret me çështje të tilla si korrupsioni, reflekton qarte integritetin bazë të organizatës dhe të individëve brenda tij.

2. Qëllimi & Shtrirja

Qëllimi i këtij udhezimi për Anti-Mashtrimin dhe Anti-Korrupsionin është:

1. Të ndërgjegjësojë të gjithë bashkëpunëtorët për mënyrën se si organizata SOS e konsideron dhe merret me korrupsionin:
2. Të skicojë përgjegjësitë e ndryshme për të gjithë bashkëpunëtorët.
3. Të këshillojë masat që duhet të ndermerren në rast kur ndodh një mashtrim apo korrupsion, apo pretendohet se ka ndodhur.

Zbatohet për bashkëpunëtorët në të gjithë nivelet si brenda Sekretarit të Përgjithshëm (SP) dhe shoqatave anëtare të tij, të cilat janë organizata që marrin fonde sic janë Shoqata Nacionale (ShN) dhe Promoting & Supporting Associations (PSAs), përfshirë këtu edhe anëtarët e bordit dhe njerezit e besuar.

3. Parimet Bazë

SOS Fshatrat e Fëmijëve kanë përshtatur parimet bazë, si më poshtë, si pjese themelore per trajtimin e mashtrimit dhe korrupsionit:

- “Tolerance-zero” në përqasjen e të gjitha formave të mashtrimit dhe korrupsionit.
- Të kuptohet që korrupsioni nuk kufizohet vetëm me akte jo-ligjore.
- T'u përmbahemi vlerave etike.
- Të reagohet ndaj akuzave në mënyrë ndershme, të hapur dhe transparente.
- Të raportohet një aktivitet që dyshohet si ilegal dhe/ose kriminal, tek autoritetet e duhura për të investiguar dhe për të marrë masa.
- Lidhshipi vjen nga “lart”, ku SP ka një rol kyç. Këtu përfshihet përkufizimi i standarteve bazë të përshtashme dhe kontrollet që duhet të zbatohen.

4. Përkufizime & Shkurtime

Korrupsioni brenda kontekstit të SOS Fshatrave të Fëmijëve është përkufizuar si *një akt apo akte që përfshin keqpërdorimin e pozitës apo autoritetin e një personi në mënyrë që të përfitojë për interes personal apo interes të një personi tjetër apo të një entiteti*. Kjo përfshin, abuzimin me fuqinë për përfitim personal financiar. Shembujt përfshijnë këtu mitmarrjen, "rryshfetet", zbulimi i informacioneve konfidenciale apo keqpërdorimi i burimeve organizative.

Ndërsa në mënyrë jo gjithëpërfshirëse, korrupsioni përfshin – por që nuk kufizohet me – veprimet dhe aktivitete e mëposhtme.

- 1 **Mitmarrje:** atëherë kur një person, organizatë apo institucion në mënyrë të papërshtatshme siguron mall apo shërbim përkundrejt disa formave të gabuara të shpërblimit. Kjo përfshin të paktën dy palë.

Këtu përfshihen gjithashtu **rryshfetet**, një formë e mitmarrjes, ku gjatë procesit të blerjes, dikush përfiton një “shpërblim” nga furnitori për të arritur një shërbim.

- 2 **Konflikti i Interesit:** ndodh atëherë kur një bashkëpunëtor apo një organizatë në terësi ka një interes që mund të kompromentojë veprimet e tyre. Konflikti i interesit nuk ka të bëjë me veprimet e papërshtatshme.
- 3 **Përvetësimi** : vjedhje e burimeve për përdorim personal. Kjo mund të përfshijë vetëm një person.
- 4 **Zhvatje:** është akti kur përvetëson dicka me forcë, kercënime apo kërkesa të paligjshme.
- 5 **Vjedhje:** përfshin transportimin e pa autorizuar apo përdorimin e pronës së organizatës apo të pronës të një bashkëpunëtori apo pronën e një personi tjetër apo entiteti të

vendosur në hapësirën e organizatës.

- 6 **Favorizim:** është favorizim i padrejte i një personi apo të një grupi, në shpenzim të të tjerëve. Këtu përfshihet edhe **nepotizmi**, i cili përkufizohet si favorizim ndaj të afërmeve (sidomos kur akordohen privilegje apo poste pune)

Mashtrimi: si forme e korrupsionit, është një mashtrim kriminal apo prezantim i të dhënave të rreme për të arritur përfitime të padrejta. Në kontekstin e SOS-it, shpjegohet si një keqpërdorim i paramenduar apo i pandershëm i burimeve të organizatës, përfshirë këtu edhe veprime të pandershme, mashtrime, perdorimi i papërshtatshëm i influences apo pozites dhe\ose përdorim i papërshtatshëm i informacionit.

Si shembuj të veprimeve mashtruese mund të permenden:

1. Vjedhja e asetëve
2. Përdorim i pa-autorizuar dhe\ose ilegal i burimeve të organizatës, i informacionit apo shërbimeve për qëllime personale
3. Përvetesim i fondeve
4. Fallsifikim i të dhënave për përfitim të pandershëm.
5. Ditë lejeje të parregjistruara
6. Akte të mitmarrje dhe përvetësimit

Bashkëpunëtor pershin të gjithë punonjësit e SP, SHN, PSAs, trajnuesit, studentet ne praktike, vullnetare, dhe kontraktuesit nga SOS-i.

Menaxher do të thotë, cdo bashkëpunëtor i caktuar në një pozicion pune në SOS Fshatrat e Fëmijëve ku ato janë përgjegjes për mbikqyrjen direkte të bashkëpunëtoreve, apo janë përgjegjes për menaxhimin e një projekti, faciliteti apo vendi brenda SOS Fshatrave të Fëmijëve.

Drejtor Nacional eshte kreu i anetareve te shoqates, duke pershire edhe Drejtuesit Menaxherialë.

Personi përgjegjes eshte një person i emeruar nga Drejtori Nacional i një ShN\PSA, apo nga SP, i cili është i autorizuar për të vepruar në bazë të informacionit të marrë në lidhje me mashtrim dhe korrupsion të mundshëm Brenda SOS Fshatrave të Fëmijëve.

5. Pasojat e Korrupsionit

Pasojat e korrupsionit ndikojnë negativisht si në organizatë dhe tek individet e përfshirë.

Efektet e mundshme në organizatë:

- 1 Humbja e reputacionit dhe emri i mire tek aktorët.
- 2 Pakësimi i fondeve të mundshme për shkak të mungesës së besimit dhe konfidences nga donatorët.
- 3 Rritja e kostove për realizimin e aktiviteteve dhe biznesit.
- 4 Përjashtim nga aktivitete të ndryshme dhe/ose reduktim i bashkëpunimit me partneret kyc të jashtëm.
- 5 Impakt negativ në mjedisin e punës ndërmjet bashkëpunëtorëve të shoqatës.
- 6 Reduktim në cilësinë e punës si pasoje e furnitorëve pa performance të cileve u është dhënë një projekt apo kontratë në mënyrë korruptive.

Efektet e mundshme tek individet e mundshëm:

- 1 Shkatërrimi i karrierës dhe reputacionit
- 2 Sanksionim të punësimit sic është humbja e punës
- 3 Masa penale apo civile të ndërmarra nga organizata
- 4 Do të vihen në siklet dhe do t'u vijë turp nga miqtë dhe familja.
- 5 Reduktim i shërbimeve direkte dhe i mbështetjes tek përfituesit.

6. Përgjegjësitë

Përgjegjësitë e SOS Fshatrave të Fëmijëve (në nivel nacional)

Fshati i femijeve SOS (në nivel nacional) ka përgjegjësi:

1. Për të ofruar siguri të mjaftueshme për parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit. Kjo përfshin sigurimin e objekteve dhe ruajtjen e pasurisë, si dhe procedurat për të penguar aktivitetin e korruptuar ose vjedhjet që ndodhin.
2. Të sigurojë mekanizma për marrjen e informacionit nga bashkëpunëtorët, aktorët dhe anëtarët e publikut të gjerë, në lidhje me mashtrim të dyshuar ose aktivitetet e korruptuar brenda shoqatës anëtare.
3. Të kryejë një hetim të të gjitha ankesave të marra lidhur me mashtrime aktuale / të dyshuara ose korrupsion. Hetimet do të kryhen në një mënyrë profesionale nga Drejtori Nacional ose nga personi përgjegjës dhe, kur është e nevojshme apo e domosdoshme, me ndihmën e Burimeve Njerëzore ose Konsulentit Ligjor. Rezultatet e hetimit duhet t'i raportohen Drejtorit Nacional për veprime të mëtejshme. Në rastet kur ekziston një konflikt apo interes, apo akuzat mund të përfshijnë Drejtorin Nacional, ata duhet të raportohen drejtpërdrejt tek Kryetari i Bordit dhe personi përgjegjës.
4. Të sigurojë që anëtarët e Bordit, menaxherët dhe bashkëpunëtorët janë të vetëdijshëm për

përgjegjësinë e tyre në lidhje me mashtrimin dhe korrupsionin.

5. Te nxise një kulturë dhe mjedis në të cilin mashtrimi dhe veprimtaria e korruptuar dekurajohet dhe raportohet nese ndodhin.

Përgjegjësia e stafit menaxherial

Menaxheret janë përgjegjës:

1. Te drejtojnë sipas shembullit për të krijuar një mjedis në të cilin mashtrimi dhe korrupsioni dekurajohet, dhe bashkëpunëtorët të ndjehen rehat në raportimin e akuzave, duke përfshirë rastet e dyshuara për mashtrim dhe korrupsion. Ky mjedis krijohet nga vetë qëndrimi i Menaxherit ndaj mashtrimit dhe korrupsionit, përgjegjshmërisë dhe integritetit që ata inkurajojnë nga bashkëpunëtorët e tyre. Performanca e një Menaxheri në lidhje me kontrollin e mashtrimit dhe korrupsionit do të jetë pjesë e vlerësimit të performancës së tyre.
2. Te raportojnë mashtrimin dhe korrupsionin e dyshuar tek Drejtori Nacional ose Personi Përgjegjës. Raportet e tilla duhet të bëhen pa marrë parasysh nëse aktiviteti po ndodh brenda ose jashtë zonës së tyre të përgjegjësisë.
3. Te sigurojë që bashkëpunëtorët janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në lidhje me mashtrimet dhe korrupsionin dhe standardet e sjelljes që priten nga punonjësit e Fshatit të Fëmijëve SOS.

Përgjegjësia e Punonjesve:

Punonjësit janë përgjegjës për:

1. Kryerjen e funksioneve dhe e detyrave të tyre me ndershmëri. Situa të tilla ku këto principe cenohen apo mund të cenohen duhet të behen menjehere të ditura Menaxherit përkiates për zgjidhje. Ketu perfshihet cdo konflikt potencial i interesave apo perceptim konflikti.
2. Mbeshtetjen e Udhezimeve dhe e procedurave të tjera të SOS Fshatit të Femijeve që janë vendosur për të frenuar dhe menaxhuar mashtrimet dhe korrupsionin. Nje thyerje e Udhezimeve mund të coje ne marrjen e masave disiplinore ndaj punonjesit.
3. Te treguarit kujdes për burimet që kanë nën kontroll dhe raportimi tek Menaxheri I tyre për situatat kur ata janë në dijeni që burimet janë në rrezik vjedhjeje.
4. Njoftimi I menjehershëm I Menaxherit për cdo rast mashtrimi apo korrupsioni për të cilin ata vihen në dijeni
5. Raportimi I punonjesve të tjerë apo paleve të treta të përfshira në mashtrime apo korrupsion, e bere kjo ne perputhje me Udhezimet
6. Raportimi i cdo konflikti potencial interesi që ata mund të jene në dijeni pavaresisht nese ka patur apo jo permiresim/ rritje të tij

7. Procedurat e Raportimit dhe të hetimit

Te gjithë anetaret e bordit, Menaxheret dhe stafi (i te gjithë niveleve) janë plotësisht të

pergjegjshem per te reaguat sa here qe dyshohet per nje rast korrupsioni. Nje akt I dyshimte korrupsioni eshte nje arsye e mjaftueshme per te reaguat.

- 1 Menaxheret dhe stafi qe jane ne dijeni te ndonje rasti korrupsioni , mashtrimi apo te ndonje rasti te mundshem mashtrimi apo korrupsioni duhet te raportojne ngjarjen tek
 - a) Menaxheri I tyre dhe / ose Personi Pergjegjes
 - b) Drejtori NacionalNe rastet kur gjykohet e pershtatshme , ngjarja mund te raportohet tek personi pergjegjes ne GSC.
- 2 Ngjarjet e korrupsionit te kryera nga Menaxheret apo personat pergjegjes I dergohen Drejtorit Nacional
- 3 Ne rastet e deklaratave serioze te marra, Drejtori Nacional duhet te vere menjehere ne dijeni personat pergjegjes ne GSC te cilet duhet t'i shkruajne (raportojne) sa me shpejt te jete e mundur per ngjarjen IO.
- 4 Te gjitha deklaratat per mashtrime apo korrupsion te marra(anonime apo jo) do te hetohen nga nje Personi pergjegjes brenda nje muaji nga marrja e tyre. Personat qe kane bere deklaraten origjinale nuk duhet te perfishihen si pjese e ekipit hetimor.
- 5 Hetimi do te behet nga nje Personi Pergjegjes ne nje menyre te tille qe te mbroje identitetin e personit/personave qe bejne deklaraten.
- 6 Procesi hetues dhe te dhenat qe gjenden do te dokumentohen ne menyre te qarte dhe nje raport do i jepet Drejtorit Nacional dhe nje kopje do I jepet perfaqesuesit/personit pergjegjes ne SP.
- 7 Ne varesi te fakteve nga hetimi do te merret nje vendim nga Drejtori Nacional dhe personi pergjegjes ne GSC per te vendosur se cilat do te jene hapat e metejshem.Kjo mund te kerkoje nje hetim te jashtem apo nje audit. Ne rast te evidentimit te parregullsive ceshtja duhet te raportohet ne Bordin e Drejtuesve(nga Drejtori Nacional) dhe ne IO(nepermjet personit pergjegjes ne GSC) per veprime te metejshme dhe/ose komunikim tek PSA-te nese shikohet e arsyeshme.
- 8 Cdo mase disiplinore qe do te ndermerret ndaj nje Bashkepunetori do te behet ne perputhje me kushtet e punes apo kodin e sjelljes si dhe ne perputhje me ligjet perkatese lokale te punes /punesimit.
- 9 Ne rastet kur deklaratat per mashtrime apo korrupsion vertetohen, organizata do te marre veprimet disiplinore te pershtatshme duke perfshire ketu edhe paditjen e bashkpunetoreve te perfshire.
- 10 Personi pergjegjes do te beje nje inspektim te vendit ku u zbulua mashtrimi apo korrupsioni per te percaktuar shkakun e ndonje avarie gjate kontrollit dhe do te beje efektive ndryshimet ne sisteme apo dhe procedura nese do te jete e nevojshme. Eshte pergjegjesi e Menaxherit perkates qe te zbatoje rekomandimet e bera nga Personi Pergjegjes.
- 11 Te gjitha shpjegimet qe kane nje natyre te rendesishme per mashtrimin apo korrupsionin do ti raportohen deges apo sherbimit policor Anti-Korrupsion nga ana e Personit Pergjegjes.

8. Sanksionet dhe Veprimet Ligjore

Cdo bashkë-punëtor që zbulohet se është përfshirë në një aktivitet mashtues dhe/ose korruptive apo ka qene neglizhent në kryerjen e detyrave të dhëna nga supervizori do të t'i nënshtrohen masave disiplinore, përfshirë këtu edhe përfundimin e mundshëm të punësimit. Nëse është e sigurtë kjo gjë, SOS-I do të nisë procedurat civile dhe/ose penale kundër personave të përfshire.

Cdo bashkë-punëtor që është në dijeni të korrupsionit të mundshëm, por nuk e raporton atë në përputhje me këto udhëzime, do të konsiderohet si shkelje të detyrimeve të tyre dhe do t'i nënshtrohen masave disiplinore.

Cdo bashkepunëtor që bën një deklaratë duke e ditur që është false, apo tregohet I pamatur nëse është false, mund t'i nënshtrohen masave disiplinore ligjeve kombetarë.

9. Raste të vecanta

Dhuratat:

Pranimi i dhuratave të natyrës dhe me vlere simbolike të dhururara në shenjë mirenjohjeje apo sipas zakonisht të vendit, nuk konsiderohen si korrupsion brenda kontekstit të këtyre udhëzimeve. Sidoqoftë, në mënyrë që të shmangët ideja e një konflikti të interesit, të gjitha dhuratat që marrin bashkëpunëtorët, për shkak të punës së tyre, duhet të raportohen tek drejtuesit e tyre të drejtpërdrejtë. Dhuratat që e kalojnë vlerën e 50 USD (ose shuma ekuivalente në monedhen vendase) nuk duhet të pranohen nga bashkëpunëtorët.

Pagesat e detyrueshme:

Bashkëpunëtorëve të cilëve u kërkohet të ndërmarrin ndonjë veprim jo të duhur, apo të bëjnë pagesa të papërshtashme në rrethana të vecanta, duhet të raportojnë çështjen menjehere me shkrim te drejtuesi i tyre. Cdo pagesë vijuese duhet t'i bëhet e ditur Drejtorit Nacional para se të kryhet dhe duhet të jetë subjekt auditimi. Të gjitha këto pagesa duhet të raportohen për hetime të mëtejshme duke përdorur procesin e përshkruar më lart. Çështja duhet gjithashtu të raportohet te personi përgjegjës i SP dhe Kryetarit të Bordit.

NËNSHKRIMI DHE ZOTIMI

Unë e kam lexuar me kujdes dhe kuptuar në mënyrë të qartë Udhezimet per Antikorrupsionit dhe Antimashtrimin e Fshatrave të Fëmijëve SOS. Unë jam i vetëdijshëm se Fshati i Fëmijëve SOS pret nga unë që t'i përmbahen në çdo kohë standardeve të sjelljes të përshkruara në këtë Udhezim. Unë e vlerësoj çdo aspekt të kuadrit dhe përmbajtjes së tij. Me nënshkrimin e këtij Udhezimi, unë zotohem në unison me të gjithë organizatën e Fshatrave të Fëmijëve SOS të aspiroj dhe mbaj lart standartet e sjelljes dhe mënyrës së jetesës si një parakusht i shërbimit tim ndaj Fshatrave të Fëmijëve SOS.

Unë e nënshkruaj dhe marr një kopje të këtij dokumenti. Një kopje tjetër e dokumentit të nënshkruar do të vendoset në dosjen time të personelit.

Emri:

Data:

Nënshkrimi:

Zyra Nacionale